

VENDIM
Nr. 79, datë 12.11.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 29.10.2024 dhe 12.11.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (Sh) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “MARINA BAY SARANDA” sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Dorian Çeliku, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurorët Manjola Kajana dhe Dorina Bejko.

AVOKATURA E SHTETIT, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 91, datë 24.2.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 9, datë 3.4.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2023-1001, datë 15.6.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 5, 11, 15, 16, 17, 30, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 50 dhe 71, të ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases shoqërisë “Marina Bay Saranda” sh.p.k., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme, mbi bazën e një kallëzimi penal, ka regjistruar procedimin penal nr. 108, datë 16.4.2021 (*procedimi penal nr. 108/2021*) për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar

nga neni 248 i Kodit Penal (KP). Objekti i hetimit, fillimisht, është drejtuar në lidhje me veprimet a mosveprimet e funksionarëve publikë, të dyshuara si në kundërshtim me ligjin dhe përmbushjen e rregullt të detyrës, për sa i përket dhënies me qira të pasurisë nr. 696, me emërtimin “Baza Ndihmuese” Limion, Sarandë, me sipërfaqe 39446 m², në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe pjesë e Planit të Vendorsjes dhe të Përhapjes (PVP) të miratuar nga Presidenti i Republikës me dekreten nr. 8593, datë 17.6.2014, përmes kontratës së datës 16.7.2020 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe bashkimit të shoqërive “Concord Investment” sh.p.k. dhe “Kastrati Group” sh.a., të cilat kanë krijuar në vijim shoqërinë “Marina Bay Saranda” sh.p.k. (kërkuesja), me objekt veprimtarie zbatimin dhe përmbushjen e kushteve të kontratës së qirasë. Më pas, objekti i hetimit është shtrirë edhe në lidhje me veprimet a mosveprimet e funksionarëve publikë për sa i përket dhënies me koncesion/partneritet publik privat (PPP) të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, Sarandë, pjesë e të cilit është edhe pasuria si më lart, në favor të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kastrati Group” sh.a. dhe “Edil-Al” sh.p.k.

2. Sipas akteve të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, janë ndërmarrë dy procedura paralelisht, ajo e dhënies me qira dhe ajo e koncesionit, ndërsa kjo e fundit ka filluar më herët.

3. Për sa i përket procedurës së koncesionit, ajo ka filluar me kërkesën e datës 2.9.2019 të bashkimit të operatorëve “Kastrati Group” sh.a. dhe “Edil-al” sh.p.k. drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE), së cilës bashkimi i operatorëve i ka paraqitur një propozim për procedurën konkurruese të dhënies me koncesion/PPP të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, Sarandë. Propozimi i paraqitur është pranuar dhe me shkresën e datës 10.10.2019 MIE-ja ka njoftuar bashkimin e operatorëve për shpalljen fitues nga komisioni i dhënies me koncesion, duke e ftuar për negociimin e kontratës koncesionare.

4. Në vijim, me shkresën e datës 13.1.2020, MIE-ja i është drejtuar MM-së, duke i kërkuar mendim në lidhje me projektvendimin për dhënien me koncesion/PPP të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, Sarandë. Nga ana e saj, MM-ja i është drejtuar Komandës së Forcës Detare (KFD), Drejtorisë së Miradministrimit të Pronave dhe Aseteve (DMPA), si dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Me shkresën e datës 21.1.2020, DMPA-ja ka kthyer përgjigje se nuk është kompetente për t’u shprehur për këtë procedurë, pasi ajo shqyrton vetëm procedurat e transferimit, privatizimit dhe qiradhënies së pronave dhe ato të prokurimit, sikurse koncesioni, ndërsa KFD-ja, me shkresën e datës 22.1.2020, ka kthyer përgjigje se nuk është dakord për miratimin e këtij projektvendimi, pasi sipërfaqja e pasqyruar nga përshkrimi i projektit dhe skema në relacion nuk përputhet me sipërfaqen nën administrim të portit të Sarandës dhe se krijon mbivendosje me pasurinë nr. 696 në administrim të Forcës Detare (FD), e cila është pjesë e PVP-së. Kurse Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, me shkresën e datës 22.1.2020, ka shprehur mosdakordësinë e tij për miratimin e projektvendimit, pasi koncesioni do të përfshinte edhe pasurinë nr. 696, e cila është pjesë e PVP-së, duke cenuar ndjeshëm kapacitetet operationale dhe misionin e FD-së dhe Rojës Bregdetare.

5. Pas këtij komunikimi, MM-ja, me shkresën e datës 30.1.2020 drejtuar MIE-së, ka shprehur mosdakordësinë për miratimin e projektvendimit me argumentin se është i pamundur identifikimi i pronave në përgjegjësi administrimi të MM-së që preken nga projekti, pasi të dhënat tekniko-ligjore, përfshirë dokumentacionin teknik që shoqëron projektvendimin, janë të paplota. Po ashtu, MM-ja ka bërë me dije se *“në vendndodhjen e projektit të koncesionit ajo ka në përgjegjësi administrimi 4 prona, një pjesë e të cilave janë brenda PVP-së së miratuar me dekreten e Presidentit nr. 8593, datë 17.6.2014”*.

6. Me shkresën e datës 28.5.2020, MIE-ja ka përsëritur kërkesën për mendim drejtuar MM-së, duke i bashkëngjitur kërkesës edhe një hartë të detajuar të zonës ku do të shtrihej koncesioni. Nga ana e saj, MM-ja i ka kërkuar mendim DMPA-së dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. Me shkresën e datës 18.6.2020, DMPA-ja shprehet se në zonën e Limionit MM-ja ka në administrim 4 prona dhe për sa i përket operationalitetit dhe gatishmërisë duhet të merret mendimi i Shtabit të Përgjithshëm. Ky i

fundit, me shkresën e datës 18.6.2020, ka sqaruar se çdo investim që do të bëhet nga koncesionari në portin turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, Sarandë nuk duhet të cenojë operacionalitetin, sigurinë dhe gatishmërinë e FA-së/FD-së, si dhe ushtrimin e sovranitetit dhe zbatimin e ligjshmërisë në det. Pas këtij komunikimi, me shkresën e datës 18.6.2020, MM-ja i ka dërguar MIE-së dakordësinë për zhvillimin e projektvendimit për dhënien me koncesion/PPP të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, Sarandë, duke rekomanduar që ndërtimi të mos cenojë operacionalitetin, sigurinë dhe gatishmërinë e FD-së, si dhe ushtrimin e sovranitetit dhe zbatimin e ligjshmërisë në det.

7. Në përfundim të këtij procesi, me vendimin nr. 515, datë 1.7.2020 (*VKM nr. 515/2020*), Këshilli i Ministrave ka vendosur miratimin e kontratës së koncesionit/PPP të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, Sarandë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga MIE-ja, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kastrati Group” sh.a. dhe “Edil-AP” sh.p.k.

8. Për sa i përket procedurës së dhënies me qira, ajo ka filluar me kërkesën e datës 11.6.2020 të bashkimit të shoqërive “Concord Investment” sh.p.k. dhe “Kastrati Group” sh.a. drejtuar MFE-së, së cilës bashkimi i shoqërive i ka paraqitur një ofertë të pakërkuar për marrjen me qira të pronës shtetërore të ndodhur në Gjirin e Limionit, Sarandë, me qëllim përdorimin e saj për zhvillimin e një projekti turistik. Me shkresën e datës 11.6.2020, MFE-ja i është drejtuar MM-së me një kërkesë për prononcim për projektvendimin për dhënien me qira simbolike 1 euro edhe të disa pronave në përgjegjësi administrimi të saj, ndërsa investitori ka shprehur gatishmërinë për të mos cenuar aspektet operacionale të FA-së dhe merrte përsipër “*pro bono*” ndërtimin, përkundrejt pagesës pa kosto për shtetin, të një bankine të re për ankorimin e anijeve dhe ambienteve të tjera mbështetëse në ndihmë të saj, sipas nevojave të FA-së. Për këtë kërkesë të MFE-së, MM-ja i është drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe KFD-së. Nga ana e tij, Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, me shkresën e datës 17.6.2020, i ka kërkuar KFD-së të prononcohet në lidhje me projektvendimin për dhënien me qira dhe për faktin nëse pronat e kërkuara bëjnë pjesë në PVP-në e miratuar me dekretin e Presidentit nr. 8539, datë 17.6.2014 në zbatim të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 64/2014*).

9. Me shkresën e datës 17.6.2020, KFD-ja ka informuar se në Gjirin e Limionit ka tri prona në administrim, atë nr. 696 që është brenda PVP-së, si dhe ato me nr. 1171 dhe nr. 1172, të cilat janë jashtë PVP-së, ndërkohë që për sa i përket përdorimit në të ardhmen të pasurisë, ajo e ka shprehur qëndrimin e saj në shkresat e mëparshme. Nga ana e tij, Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, me shkresën e datës 17.6.2020 drejtuar MM-së, pasi ka informuar se në bashkëpunim me FD-në ka bërë identifikimin e 3 pasurive që kërkojnë nga MFE-ja për marrjen me qira të pasurisë shtetërore në Gjirin e Limionit, Sarandë, nga të cilat vetëm njëra (ajo nr. 696) bën pjesë në PVP, në vijim është shprehur parimisht dakord për kërkesën e MFE-së, duke parashtruar se ruhet gatishmëria dhe operacionaliteti nëpërmjet ndërtimit të një bankine të re dhe të infrastrukturës mbështetëse të saj, sipas standardeve të kërkuara, duke zbatuar të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe administrative në fuqi, ndërkohë që për sa u përket të dhënave teknike që ruajnë operacionalitetin e FA-së për ndërtimin e bankinës së re dhe infrastrukturës mbështetëse të pronës brenda PVP-së, shprehej gatishmëria për t’i negociuar në fazën e hartimit të kontratës.

10. Nga ana tjetër, me shkresën e datës 18.6.2020, Shtabi i Përgjithshëm i FA-së i ka kërkuar sërish KFD-së të saktësojë nëse pronat e kërkuara bëjnë pjesë në PVP-në e miratuar, nëse cenohet operacionaliteti i saj dhe nëse duhet të jepen ose jo me qira. Për vlerësimin dhe analizimin e kësaj kërkesë, KFD-ja ka ngritur një grup pune, i cili ka përgatitur një informacion, sikundër edhe një studim për ripozicionimin e bazës ndihmuese, shoqëruar edhe me kërkesat teknike për rindërtimin e saj. Në vijim, KFD-ja, me shkresën e datës 18.6.2020, i ka kthyer përgjigje Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, duke u shprehur parimisht dakord për dhënien me qira të pjesës së ngelur jashtë hapësirës prej 7000–9000 m², mbi të cilën do të duhej të shtrihej projekti i bazës së re ndihmuese të Limionit,

ndërtimi i së cilës ishte marrë përsipër “pro buono” nga investitori strategjik, ndërsa ka parashtruar edhe kërkesat e përgjithshme, teknike dhe procedurale. Shkresa e KFD-së i është përcjellë në vijim MM-së nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së me shkresën e datës 18.6.2020.

11. Nga ana e saj MM-ja, me shkresën e datës 18.6.2020 drejtuar MFE-së, ka shprehur dakordësinë për kryerjen e investimit në Gjirin e Limionit, pasi ka marrë dakordësinë nga strukturat në varësi të saj (duke i bashkëngjitur prononcimet e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së me shkresën e datës 17.6.2020 dhe të KFD-së me shkresën e datës 18.6.2020).

12. Në përfundim të këtij procesi, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 514, datë 1.7.2020 (VKM nr. 514/2020) ka vendosur dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata ndërmjet MFE-së, si qiradhënës, dhe bashkimit të shoqërive “Concord Investment” sh.p.k. dhe “Kastrati Group” sh.a., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore me sipërfaqe të përgjithshme 265299,5 m², të përbërë, ndër të tjera, edhe nga pasuria nr. 1/416, vol. 30, f. 157, truall, me sipërfaqe 39446 m² (pasuria nr. 696), në pronësi dhe përgjegjësi administrimi të MM-së, për një periudhë 20 (njëzet) vjeçare, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës që i bashkëlidhen këtij vendimi.

13. Në datën 8.7.2020 bashkimi i operatorëve “Concord Investment” sh.p.k. dhe “Kastrati Group” sh.a. kanë krijuar shoqërinë koncesionare “Marina Bay Saranda” sh.p.k., ndërsa në datën 16.7.2020 është nënshkruar dhe kontrata e qirasë me MFE-në sipas VKM-së nr. 514/2020. Qëllimi i kontratës është përcaktuar të jetë dhënia në gëzim të përkohshëm i pasurisë, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë në fushën e turizmit (neni 2), duke pasur qiramarrësi të drejtën që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të për gjithë kohën që kontrata është në fuqi (neni 5, pika 1), ndërsa në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt të kontratës ai do të investojë për të ngritur kompleks me infrastrukturë “Pro turizmi”, me ambiente të dedikuara argëtimit, ambiente të dedikuara mirëqenies, ambiente për biznes, ambiente akomoduese dhe shërbime hoteliere, restorante dhe bare, klube të hapura në natyrë (*Clubs*), dyqane suveniresh dhe librari, guida turistike dhe port jahtesh (neni 5, pika 7), ndërkohë që, sipas kushteve të propozuara nga MM-ja, duhet të ruhet gatishmëria dhe operacionaliteti nëpërmjet ndërtimit nga qiramarrësi të një bankine të re dhe infrastrukturës mbështetëse të saj, sipas standardeve të kërkuara (neni 5, pika 8). Në përfundim të kontratës qiramarrësi detyrohet të dorëzojë pronën të padëmtuar (neni 5, pika 13), duke pasur të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë, ndërkohë që nuk gëzon të drejtën e kompensimit financiar për investimet e kryera në pasuri të paluajtshme (neni 5, pika 14).

14. Megjithatë, pasuritë objekt të kontratës së qirasë në administrim të FD-së, ndër to edhe pasuria nr. 696, nuk janë dorëzuar menjëherë. Në periudhën në vijim, duke qenë se pasuria nr. 696 ka qenë pjesë e PVP-së, Shtabi i Përgjithshëm i FA-së ka pasur një komunikimin shkresor me Presidentin e Republikës, përmes shkresave të datave 2.2.2021 dhe 31.3.2021, ku ka informuar se vendbazimi detar, me vendndodhje Limion, Sarandë (prona nr. 696), me VKM-në nr. 514/2020 pjesërisht i është dhënë me qira shoqërisë kërkuuese dhe se për të ruajtur aktivitetin dhe për të mos cenuar operacionalitetin e strukturës së FA-së ajo shoqëri ka marrë përsipër ndërtimin e një bankine të re dhe infrastrukturës mbështetëse të saj sipas standardeve të kërkuara nga KFD-ja, ndërkohë që prona nuk është dorëzuar deri në saktësimin, garantimin dhe përmbushjen e detyrimeve nga ajo shoqëri sipas kërkesave të KFD-së. Prona nuk ka dalë nga PVP-ja dhe ajo në të ardhmen do të mbetet aset i FA-së.

15. Me urdhrin nr. 473, datë 7.4.2021, ministri i Mbrojtjes ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektit të ndërtimit të bankinës së re dhe infrastrukturës mbështetëse të saj në pronën në administrim të MM-së, në zbatim të kontratës së qirasë, duke urdhëruar gjithashtu edhe që dorëzimi përfundimtar i pronës të kryhet pas realizimit të projektit të ndërtimit të bankinës së re dhe infrastrukturës mbështetëse nga qiramarrësi sipas aktmarrëveshjes së arritur me FD-në.

16. Pavarësisht termave të kontratës (nenit 5, pika 8), është kërkuar ajo që me shkresën e datës 7.5.2021 i ka dërguar KFD-së një propozim në lidhje me ndërtimin e bankinës së re dhe infrastrukturës mbështetëse të saj në Gjirin e Limionit.

17. Në vijim, me vendimin nr. 8, datë 10.6.2021, Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) ka vendosur “1. Miratimin me kusht të lejes së ndërtimit për objektin porti turistik dhe i shërbimeve “Marina Limion” dhe kompleksi turistik “Marina Bay Saranda”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me zhvillues shoqëritë “Concord Investment” sh.p.k., “Marina Limion” sh.p.k. dhe “Marina Bay Saranda” sh.p.k.”.

18. Me shkresën e datës 23.6.2021, Presidenti i Republikës në mënyrë të përsëritur i ka kërkuar MM-së informacion të hollësishëm për pronat brenda PVP-së të dhëna në përdorim, qira apo enfitozë, pa marrë më parë miratimin me dekret të posaçëm nga Presidenti i Republikës, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të FA-së, sikurse kërkohet nga ligji nr. 64/2014. Me shkresën e datës 29.7.2021, Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, në vijim të komunikimeve të mëparshme, ka informuar Presidentin e Republikës se në zbatim të VKM-së nr. 514/2020, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr. 473, datë 7.4.2021, është ngritur grupi i punës me qëllim hartimin e projektit përfundimtar për ndërtimin e bankinës së re dhe infrastrukturës mbështetëse në pronën nr. 696, për t'u bërë pjesë e kontratës ekzistuese me subjektin qiramarrës, ndërkohë që dorëzimi i pronës do të bëhet pas realizimit të projektit, sipas aktmarrëveshjes përkatëse. Me ndërtimin e bankinës dhe infrastrukturës ndihmuese sipas kërkesës operacionale të FD-së, shprehur edhe në prononcimin e saj, nuk cenohet operacionaliteti i asaj force.

19. Ndërkohë, në lidhje me propozimin e qiramarrësit për ndërtimin e bankinës së re dhe infrastrukturës mbështetëse të FD-së në Gjirin e Limionit, KFD-ja është shprehur me shkresën e datës 2.8.2021, duke miratuar atë propozim, ndërsa në datën 10.12.2021, përmes aktmarrëveshjes nr. 4389 prot., KFD-ja ka rënë dakord për dhënien akses kërkuar për fillimin e punimeve për ndërtimin e objekteve në interes të KFD-së në pronat në administrim të saj në Gjirin e Limionit, Sarandë.

20. Në vijim, përmes procesverbaleve të datave 29.3.2022 dhe 30.3.2022, komisioni i ngritur me urdhrin nr. 90, datë 12.3.2022 të KFD-së i ka dorëzuar kërkuar 3 pronat objekt të kontratës së qirasë, ndër to edhe pasurinë nr. 696, ndërsa me shkresën e datës 4.4.2022 KFD-ja ka informuar MFE-në për dorëzimin e pronave në administrim të FA-së në Gjirin e Limionit, Sarandë.

21. Ndërkohë, në përgjigje të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, me shkresën e datës 10.5.2022, Presidenti i Republikës ka informuar se me dekretin nr. 8539, datë 17.6.2014, në zbatim të ligjit nr. 64/2014, është miratuar PVP-ja e FA-së, ku në pikën 4.5, nën-pikat 4.5.37 dhe 4.5.38, renditen pronat që përkojnë me pronën objekt hetimi, për të cilën pranë institucionit të Presidentit të Republikës nuk është depozituar asnjë dokument shkresor (kërkesë/relacion) nga MM-ja për nxjerrjen jashtë PVP-së së FA-së dhe se deri në këtë moment prona nr. 696, sipas legjislacionit në fuqi, është pjesë e PVP-së së FA-së.

22. Pas administrimit të praktikës dokumentare në lidhje me procedurat objekt hetimi, si dhe marrjes së deklarimeve nga disa zyrtarë të përfshirë në ato procedura, në datat 6 dhe 7.4.2022, Prokuroria e Posaçme i ka paraqitur gjykatës një kërkesë për caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për pasurinë nr. 696, me emërtimin “Baza Ndihmuese”, Limion, Sarandë, bazuar në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Sipas Prokurorisë së Posaçme, veprimet e kryera gjatë procedurave të përfunduara me VKM-të nr. 514/2020 dhe nr. 515/2020 dyshohet se janë në kundërshtim me ligjin, pasi: (i) është disponuar në favor të subjekteve private për një pronë (nr. 696) destinacioni i së cilës është i përcaktuar me dekret të Presidentit të Republikës dhe ajo është e vendosur në PVP-në e FA-së dhe, si e tillë, nuk mund të disponohet lirisht nga subjekte private; (ii) organi në varësi që ka autoritetin e drejtimit dhe të kontrollit (KFD-ja) nuk ka dhënë pëlqimin për dhënien me koncesion të pronës, pikërisht për shkak të rolit të tij si organi garantues i mbrojtjes së

sigurisë kombëtare; (iii) edhe ligji për koncesionet (ligji nr. 125/2014), neni 6, shkronjat “b” dhe “gj”, përjashton mundësinë e dhënies me koncesion të asaj prone. Po ashtu, sipas Prokurorisë së Posaçme, edhe gjatë zbatimit të kontratës së qirasë konstatohet se nuk është marrë në konsideratë nevoja e KFD-së, pasi projekti i saj është reduktuar në vëllim dhe në shtrirje, duke lënë në disponim të lirë të investitorit një pronë, e cila, në fakt, është bazë ushtarake. Nisur nga karakteri i veçantë i pronës, ajo cilësohet pronë aktive në sigurinë detare dhe kombëtare, ndaj disponimi i saj te subjekte private vë në rrezik jo vetëm sigurinë kombëtare, por edhe detyrimet që shteti shqiptar ka ndaj NATO-s apo organizmave të tjerë ndërkombëtarë. Për rrjedhojë, vijon ajo, ndërsa subjektet private kanë filluar investimet mbi atë pronë, ekziston rreziku që disponimi i lirë i saj mund të lehtësojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, ndaj për të shmangur një rrezik të tillë duhet të vendoset masa e sigurimit pasuror e sekuestros preventive.

23. Me vendimin nr. 91, datë 24.2.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*) ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke vendosur masën e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për pasurinë nr. 696, me arsyetimin se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se është konsumuar vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i KP-së. Po sipas kësaj gjykate, ekziston rreziku se disponimi i lirë i pasurisë mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera, ndaj vendosja e masës së sekuestrimit parandalon rrezikun që pasuria të mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale, sikundër edhe rrezikun e shitjes, tjetërsimit apo humbjes së pasurisë. Në këtë kuptim duhet të ndërpritet kryerja e veprimeve të investimit në fushën e turizmit apo edhe e ndërtimeve të tjera nga investitori, pasi cenohet gatishmëria dhe operacionaliteti i FD-së, duke vënë në rrezik sigurinë kombëtare. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuarja, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit dhe heqjen e masës së sekuestros.

24. Me vendimin nr. 9, datë 3.4.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*) ka miratuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke ndrequr, gjithashtu, gabimin material në pikën 2 të dispozitivit në lidhje me numrin e faqes së regjistrimit të pasurisë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. GJKKO-ja e Apelit fillimisht ka vlerësuar se, në kuptim të nenit 276 të KPP-së, vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është i ankimeshëm dhe se ankimi në rastin konkret është bërë nga një subjekt që legjitimohet të bëjë ankim, ndërsa ligji i ka njohur të drejtën e ankimit cilido që ka interes, koncept ky më i gjerë se ai i së drejtës së pronës, ndërkohë që ankuesi në këtë rast ka një interes të tillë referuar të drejtave që burojnë nga kontrata e qirasë.

25. Në lidhje me çështjen, edhe GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se ekzistojnë kushtet e nevojshme ligjore për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, ndërsa ekzistojnë indicje/të dhëna për praninë e elementeve: (i) *fumus boni iuris* për kryerjen e një veprë penale apo të mundshme për t'u kryer në të ardhmen; (ii) *periculum in mora*/rreziku i vonës deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar. Për aspektin e fundit, ajo gjykatë nuk ka mbështetur arsyetimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë për rrezikun e shitjes, tjetërsimit apo humbjes së pronës, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me një truall shtetëror të përfshirë në PVP-në e FA-së, shkak për të cilin prona juridikisht nuk mund të transferohet te të tretët. Për sa i përket faktit se prona mbi të cilën është vendosur sekuestro preventive është shtetërore, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se përkatësia e pronësisë së sendit nuk paraqet relevancë në kuptim të nenit 274, pika 1, të KPP-së, ndaj një rrethanë e tillë nuk e përjashton apriori vendosjen e një pasurie të tillë nën sekuestro preventive. Sipas saj, mbi pronën shtetërore në rastin konkret mund të vendoset sekuestro preventive, në kushtet kur ushtrimi i tagrave të buruara nga kontrata e qirasë mbi atë pronë të përfshirë në PVP-në e FA-së do të rëndonte pasojat e veprës penale, duke mos përjashtuar as mundësinë e lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale, përveçse do të shtonte rrezikun për gatishmërinë dhe operacionalitetin e KFD-së, duke vënë në rrezik vazhdues interesat kombëtarë të sigurisë. Situata e fakteve në rastin konkret, vijon ajo, nuk paraqitet si një

marrëdhënie e rastësishme midis asaj pasurie dhe krimit të dyshuar të “Shpërdorimit të detyrës”, por kemi të bëjmë me një marrëdhënie të konceptueshme midis sendit dhe veprës penale.

26. Për sa i përket proporcionalitetit të masës, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se interesi kombëtar i shtetit shqiptar prevalon mbi interesat ekonomike të shoqërisë ankuese të lidhur me investimet e saj. Ndërsa në lidhje me urgjencën e masës, ajo gjykatë ka arsyetuar se parimisht nuk përjashtohet mundësia që masat e sigurimit pasuror të vendosen deri në momentin kur procedimi penal të ketë përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ndërkohë që në rastin konkret është evident fakti se investimi në pronën e marrë me qira nuk është realizuar ashtu sikurse është marrë përsipër dhe, për më tepër, masa është vendosur në një kohë kur pritej të vijonin veprimet dhe investimet mbi pronën, duke qenë kështu prezente mundësia që përdorimi/aksesimi i saj nga ankuesi të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojë edhe kryerjen e veprave të tjera penale të lidhura me pronën e sekuestruar.

27. Për rekursin e paraqitur nga kërkuesja, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1001, datë 15.6.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk konstatohet asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së për cenimin e vendimeve të gjykatave të faktit, ndërsa nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar nga ato të ligjit material apo procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, në dëm të palës rekursuese, si dhe nuk rezulton që vendimi i ankimuar të vijë në kundërshtim me praktikën e atij kolegji ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas atij kolegji, pretendimet e ngritura në rekurs janë ngritur edhe në ankim, duke marrë përgjigje të detajuar dhe shteruese nga gjykata e apelit, qoftë për sa i përket ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale, ashtu edhe për ekzistencën e rrezikut që vjen nga disponimi i lirë i pronës shtetërore, të dhënë me qira, si dhe për ekzistencën e kushteve të parashikuara nga neni 274, pika 1, i KPP-së. Përtej rastit në shqyrtim, Kolegji Penal ka çmuar të sjellë në vëmendje të organeve proceduese që të mbajnë në konsideratë faktin se administrimi i pronës duhet të mbajë të paprekur funksionin e bazës detare ndihmuese të Limionit, Sarandë dhe t’i sigurojë FD-së operacionalitetin e nevojshëm në funksion të kryerjes së detyrave që atyre u ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji në mbrojtje të Republikës së Shqipërisë.

28. Në datën 16.2.2024 kërkuesja i është drejtuar me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektivit të tij. Me vendimin e datës 26.4.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 15.5.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

29. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

29.1 *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të:

29.1.1 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk arsyeton në asnjë moment në terma konkretë mbi rrethanat, provat që ndikojnë në rastin konkret për të sjellë domosdoshmërinë e masës së sekuestros preventive. Në vendim janë parashtruar thjesht rrethanat faktike siç janë parashtruar nga prokuroria pa bërë ndonjë analizë ligjore për ndonjë prej tyre në veçanti apo lidhjen e tyre me nevojat e marrjes së masës së sekuestros preventive, urgjencën në marrjen e masës, mënyrën se si ndikojnë në rëndimin e veprës penale të dyshuar apo qoftë edhe në mundësinë

e ardhjes së veprave të tjera penale. I gjithë arsyetimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë përmbledhet në paragrafin 62 të vendimit dhe nuk ka asnjë arsyetim dhe as që përmendet ndonjë rrethanë/provë/indicje ose mënyra se si ato do të ndikonin në drejtim të parandalimit të pasojave të veprës penale së dyshuar apo veprimeve të tjera si një garanci procedurale penale dhe njëkohësisht e drejtë themelore kushtetuese. Edhe GJKKO-ja e Apelit ka miratuar një vendim të paarsyetuar, në shkelje të garancive procedurale penale e kushtetuese të palës së interesuar. GJKKO-ja e Apelit nuk mundet ta miratojë vendimin e shkallës së parë mbi një arsyetim të munguar dhe mbi një arsyetim që bëhet rishtazi dhe nuk gjendet në vendimin e ankimuar, pasi kjo vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 276 të KPP-së. Edhe Gjykata e Lartë nuk e ka konstatuar mungesën e plotë të arsyetimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke e konsideruar konciz dhe të përmbledhur, kur në fakt arsyetimi i rrethanave konkrete dhe/ose mënyra se si ato do të ndikonin në drejtim të parandalimit të pasojave të veprës së dyshuar apo veprimeve të tjera kriminale është dukshëm inekzistent në atë vendim. Në asnjërin prej vendimeve objekt kërkesë nuk parashトロhet, evidentohet ose arsyetohet ndonjë dyshim i arsyeshëm lidhur me shkeljen e dispozitave ligjore për sa i përket kontratës së qirasë që ka disponuar pronën objekt sekuestroje.

29.1.2 *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi vendimet e GJKKO-ve në mënyrë të dukshme konfondohen me rrethana të dyshimeve për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe konfundojnë kontratën koncesionare me kontratën e qirasë. Gjykatat e faktit kanë arritur në konkluzion duke mos marrë mendimin e një specialisti të fushës, i cili do të ishte përcaktues, pasi qartësisht kontrata koncesionare nuk ka asnjë lidhje me atë të qirasë, por përfshihet vetëm në komunikimet e paraqitura si provë të lidhura me komunikimet rreth lidhjes së kontratës së qirasë, që krijojnë dukje të gabuar dhe dyshime të rreme për faktet penale të paraqitura. Kolegji Penal nuk e ka konstatuar konfondimin dhe paqartësinë e gjykatave të faktit në drejtim të analizës dhe argumentit të plotë dhe të qartë që ato duhet të jepnin për të sqaruar ndarjen ndërmjet kontratës koncesionare dhe asaj të qirasë. Argumentimi konfuz dhe mosdallimi i tyre cenon argumentin e posaçëm që duhet të japin gjykatat për plotësimin e të gjitha elementeve dhe kriterëve të parashikuara nga neni 274 i KPP-së si dyshim i arsyeshëm i kryerjes së veprës penale dhe fakti që disponimi i lirë i sendit të rëndojë apo të zgjasë pasojat e saj cenon parimin e prezumimit të pafajësisë që duhet të jetë absolut, sidomos në fazën që gjendet hetimi i themelit të kësaj çështjeje. Kallëzimi penal është paraqitur 2 vjet para se të kërkohej nga prokuroria dhe të caktohej nga gjykata masa e sekuestros preventive, për rrjedhojë është vendosur jashtë kontekstit kohor apo urgjencës në ardhjen e pasojave, rëndim të tyre apo qoftë edhe për vepra të tjera penale potenciale. Nga provat e organit të akuzës nuk evidentohet ndonjë dyshim i arsyeshëm për kryerjen e ndonjë veprë penale.

29.2 *Të drejtën e pronës private*, pasi pavarësisht se në vendimet gjyqësore disponohet për vendosjen e masës së sekuestros preventive vetëm për pasurinë nr. 696, me sipërfaqe 39.446 m², në fakt ky kufizim i të drejtave të ligjshme pasurore që vijnë si rezultat i një marrëdhënieje kontraktore me shtetin dhe mbi të cilën është dhënë edhe leja e ndërtimit është shumë herë më i madh dhe thelbësor sesa arsyetohet në vendimet gjyqësore. Këto vendime gjyqësore kanë bllokuar të gjithë projektin investues dhe një kufizim i tillë do të sjellë pasoja të pashmangshme në drejtim të cenimit të interesit publik. Masa e sekuestros ka sjellë pasoja shumë të mëdha financiare për kërkuesen, pasi janë shpenzuar tashmë vlera të konsiderueshme monetare dhe ajo është e detyruar që t’u paguajë nënkontraktorëve edhe penalitete për moslejimin e fillimit të punimeve në kohë për shkaqe që nuk janë rrjedhojë e veprimeve të këtyre subjekteve. Vendimet nuk arsyetojnë lidhur me proporcionalitetin e kufizimit të të drejtave pronësore, që në fakt i gëzon vetë shteti shqiptar si pronar i vetëm i pronës objekt sekuestro, dhe të drejtave pasurore të kërkueses apo edhe të dëmeve që po i shkaktohen dhe do të vijnë t’i shkaktohen shtetit shqiptar nga mosrespektimi i kontratave (koncesionare dhe qiraje) dhe lejes së ndërtimit. Nga vetë qëllimi i kontratës së qirasë dhe kushtet e saj është i qartë elementi i interesit publik

të investimeve të shoqërisë, ku jo vetëm për sa i përket infrastrukturës së Bazës Ndihmuese, por edhe në tërësi investimi turistik në sipërfaqen tej asaj të administruar nga KFD-ja do të mbetet në pronësi shtetërore dhe nuk do të përfitohet nga kërkesja, e cila ka vetëm të drejtën e qiramarrjes dhe shfrytëzimit të përkohshëm të infrastrukturës turistike, duke pasur detyrimin që t'ia kalojë shtetit në përfundim të afatit të qirasë. Kufizimi që i shkaktohet vetë shtetit është thelbësor në të drejtën absolute të pronësisë, por edhe kërkeses dhe subjekteve të tjera, pavarësisht faktit që ato kanë të drejta posedimi dhe pasurore të miratuara nga vetë organet përfaqësuese të shtetit shqiptar. Pretendimi i prokurorisë i pranuar nga gjykatat për cenimin e sigurisë kombëtare nga delegimi i kompetencave të operacionalitetit të bazës nga KFD-ja të kërkesja është një pretendim i pambështetur aq sa edhe absurd, pasi nga përmbajtja dhe kronologjia e ngjarjeve faktike dhe shkresave që pasqyrojnë këtë ngjarje provohet e kundërta. Interesi publik dhe siguria kombëtare janë duke u rrezikuar nga vendimet që kanë caktuar sekuestron preventive dhe situata faktike aktuale në pronën e sekuestruar.

30. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

30.1 Në lidhje me pretendimin *për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit*, gjykatat e posaçme i kanë argumentuar qartë vendimet e tyre për sa i takon dyshimit të arsyeshëm. Po ashtu, edhe kërkesa e Prokurorisë së Posaçme ka qenë e arsyetuar në mënyrë të qartë dhe shteruese në respektim të kërkesave ligjore, si dhe të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta.

30.2 Pretendimi për *cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë* nga ana e Prokurorisë së Posaçme është i pabazuar, pasi vepra penale e regjistruar në kuadër të procedimit penal nr. 108/2021, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, mund të konsumohet vetëm nga subjekte që ushtrojnë funksione publike, pra kjo vepër nuk mund të kryhet nga kërkesja, për rrjedhojë nuk mund të ngrihet një pretendim i tillë prej saj.

30.3 Pretendimi për *cenimin e së drejtës së pronës* është i pabazuar, pasi mosrespektimi i dispozitave ligjore nga autoritetet përgjegjëse gjatë veprimeve të tyre hedh dyshime të arsyeshme për konsumimin e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” nga funksionarët publikë dhe vijimi i disponimit me kontratat e qirasë ose koncesionit nga qiramarrësi/investitori e vendos pasurinë përballë rrezikut konkret të humbjes së plotë të funksionit themelor të saj. Sekuestroja preventive për pasurinë nr. 696 është vendosur pasi ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se kjo pasuri publike dhe aktet e nxjerra nga funksionarët publikë për disponimin e saj përbëjnë sende që lidhen me veprën penale. Disponimi i lirë nga qiramarrësi/investitori nëpërmjet kontratave të qirasë/koncesionit për këtë pasuri mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e veprës penale, duke vijuar me investime private në pronën publike që cenojnë sigurinë kombëtare të vendit, ruajtjen e gatishmërisë dhe operacionalitetin e njësive apo reparteve të dislokuara në këto prona, si dhe të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Vendimet gjyqësore kanë vendosur një ndalim të përkohshëm në të drejtën e kërkeses për gëzimin e pasurisë së paluajtshme. Ndërhyrja në të drejtën e pronës është bërë me ligj dhe i përgjigjet interesit publik, i cili është i prezumuar në këtë rast, pasi rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal në kuptim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike nga veprimtaria kriminale. Masa e sekuestros e justifikon nevojën e ndërhyrjes, sepse synon të ndalojë rëndimin/zgjatjen e pasojave të veprës penale të dyshuar, si dhe të pengojë çdo lloj disponimi tjetër të mundshëm për pasurinë nr. 696 dhe aktet e tjera që lidhen me të, duke pasur synim final mbarëvajtjen e procedimit penal. Kjo masë është e përshtatshme, pasi mbetet një mjet me natyrë të përkohshme që balancon në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme qëllimin e procedimit penal me interesat e kërkeses dhe nuk është më e ashpër se sa objektivi që kërkohet të arrihet, pasi kufizimi i së drejtës së kërkeses për të gëzuar dhe poseduar pasurinë publike të marrë me qira vendoset përballë objektivit për të parandaluar kryerjen e mëtejshme të veprës penale. Midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, prandaj kufizimi i së drejtës së kërkeses

për të gëzuar dhe poseduar pasurinë publike të marrë me qira është në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar kufizimin.

31. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkesës

32. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

33. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata thekson, së pari, se në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të tyre dhe me thelbin e këtyre të drejtave e lirive. Kërkesja është person juridik i krijuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese të pretenduara të cenuara, për të cilat Kushtetuta ofron të njëjtën mbrojtje si për personat fizikë. Gjykata konstaton se objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi që ka disponuar sekuestrimin e pronës për të cilën kërkesja pretendon se mbart të drejta dhe interesa të ligjshëm, proces në të cilin kërkesja ka qenë palë dhe ka vënë në lëvizje, përmes ankimit, edhe gjykatat më të larta, vendimet e të cilave janë, gjithashtu, objekt kundërshtimi. Po kështu, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, duke pasur parasysh pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual, ashtu edhe konceptin kushtetues të pronës private, i cili është mjaft i gjerë dhe shtrihet edhe ndaj një hapësire të madhe interesash ekonomike (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vlerëson se kërkesja ka provuar se sekuestrimi i vendosur për një pjesë të pronës ku ajo ushtron veprimtarinë ekonomike sjell pasoja të drejtpërdrejta në interesat e saj ekonomikë, si aspekte të veçanta të së drejtës së pronës private. Pra, kërkesja legjitimohet *ratione personae* qoftë në aspektin procedural, ashtu dhe në atë substancial.

34. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeliemeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte. Ky rregull, në thelb, synon t’u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Për sa u përket kriterëve që duhet të plotësojë një vendim i ndërmjetëm në mënyrë që të konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata ka përcaktuar se ai: (i) duhet të ketë vendosur një kufizim mbi të drejtën e individit të pretenduar të

cenuar, pra që shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, që do të thotë se kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; (ii) duhet të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm, në kuptimin që të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë. Kjo do të thotë se cenimi është në atë masë dhe formë që pasojat e ardhura është e vështirë ose e pamundur të riparohen gjatë procesit të themelit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata ndalet në verifikimin nëse ndodhet përpara një rasti përjashtimor që lejon kontrollin kushtetues të vendimeve objekt kërkesë, pra nëse ato kanë cenuar të drejta kushtetuese të kërkueses, të cilat janë bërë objekt shqyrtimi në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm dhe nëse ajo (kërkuësja) ka arritur të provojë se pasojat në këto të drejta janë të tilla që, për nga rëndësia dhe masa e tyre, është e pamundur të riparohen gjatë gjyqimit të themelit të çështjes. Në drejtim të pariparueshmërisë së të drejtave kushtetuese të cenuara, Gjykata analizon edhe kohëzgjatjen e masës (*shih vendimin nr. 74, datë 22.10.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata vëren se objekt i ankimit kushtetues individual është procesi gjyqësor i përmbyllur me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore për pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar masën e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për pasurinë nr. 696, objekt i kontratës së qirasë dhe asaj të koncesionit, të lidhur mes kërkueses, si qiramarrëse, dhe MFE-së, si qiradhënëse. Për rrjedhojë, siç u theksua edhe më sipër, nga këto vendime kanë ardhur pasoja të drejtpërdrejta në të drejtat substanciale të kërkueses, që janë e drejta e pronës private dhe e drejta për proces të rregullt.

38. Për sa u përket pasojave të ardhura në këtë të drejtë, në drejtim të kohëzgjatjes së tyre dhe mundësisë së riparimit gjatë procesit të themelit të çështjes penale në kuadër të të cilit është marrë vendimi i ndërmjetëm për vendosjen e masës së sekuestros, Gjykata ka theksuar se procedurat paraprake, siç janë ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme, edhe pse si rregull nuk përcaktojnë të drejta dhe detyrime civile, ndodh shpesh që ato të vendosin, njësoj si vendimet e themelit, të njëjtat “të drejta ose detyrime civile” dhe të kenë të njëjtat efekte që zgjasin në kohë ose janë edhe të përhershme në lidhje me të drejtat ose detyrimet civile (*shih vendimet nr. 74, datë 22.10.2024; nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata evidenton se caktimi i masës së sekuestros preventive ka ndërhyrë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të kërkueses dhe të drejtave të ligjshme që kanë lindur për të nga kontratat e lidhura me autoritetet shtetërore, të miratuara edhe me akte nënligjore të këtyre të fundit, të cilat janë ende në fuqi për sa kohë nuk rezulton të jenë zgjidhur nga palët apo të jenë shfuqizuar, duke sjellë pasoja me natyrë financiare që lidhen me realizimin në kohë të investimit dhe kryerjen e punimeve, me pasoja edhe në marrëdhëniet nënkontraktore me palë të treta.

39. Nga ana tjetër, vendimi për caktimin e masës së sekuestros nuk ka përcaktuar një afat kohor për sa i përket kohëzgjatjes së kësaj mase, e cila është në fuqi tashmë prej rreth 21 muajsh dhe qartësisht do të vijojë të sjellë pasoja në të ardhmen, për një periudhë tjetër të papërcaktuar kohore. Nisur edhe nga ky fakt, efektet e vendimit të ndërmjetëm prekin në mënyrë të konsiderueshme të drejtat substanciale të kërkueses, pavarësisht rezultatit ose rezultateve të procesit gjyqësor të themelit të çështjes i cili lidhet me procedimin penal ndaj disa funksionarëve publikë për procedurat mbi të cilat është disponuar për këtë pasuri.

40. Në këto rrethana, për sa kohë masa e sekuestros preventive është bërë objekt kundërshtimi në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta e të zgjatura në kohë,

pra duke e bërë të vështirë ose edhe të pamundur riparimin e tyre, për rrjedhojë të vetë së drejtës substanciale të pronës private gjatë procesit të themelimit, konsiderohet se procesi gjyqësor i kundërshtuar plotëson dukshëm edhe kriterin e autonomisë. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se vendimet objekt të këtij gjykimi kushtetues përmbushin standardet kushtetuese për t'u konsideruar përfundimtare për efekt të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për rrjedhojë, kërkesja e plotëson edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion¹.

41. Në këndvështrim të këtij kriteri, të lidhur edhe me përmbajtjen e pretendimeve të kërkuases, i cili në aspektin formal të tij kërkon që pretendimet që parashtrohen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vëren se kërkesja i ka shteruar pretendimet e saj në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme, përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues.

42. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës, që në rastet e vendimeve gjyqësore konsiderohet data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e dhënë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 15.6.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 16.2.2024. Nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Lartë është sqaruar se vendimi i Kolegjit Penal është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 17.10.2023, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Për rrjedhojë, duke e konsideruar këtë të fundit si datën nga e cila ka filluar afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

43. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të parimit të prezumimit të pafajësisë, si dhe cenimin e së drejtës së pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se në rastin përjashtimor të kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, ndërsa ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, Gjykata ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 74, datë 22.12.2024; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, duke pasur parasysh se, në thelb, pretendimet e kërkuases lidhen me të drejtën e pronës, si një e drejtë që nuk mund të rikuperohet gjatë procesit të themelimit të çështjes, si dhe duke mbajtur parasysh edhe pretendimet në drejtim të procesit të rregullt në procesin gjyqësor të kundërshtuar, të cilat pretendohet se kanë cenuar të drejtën substanciale të pronës, si dhe pretendimet e prezumimit të pafajësisë, që në thelb lidhen me arsytimin e vendimeve, çmon ta shqyrtojë çështjen në vijim në drejtim të kësaj të drejte, ndërkohë që aspektet që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, do t'i trajtojë si aspekte procedurale të së drejtës së pronës së garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

¹ Gjyqtarët Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për mosplotësimin e këtij kriteri legjitimimi nga kërkesja dhe rrëzimin e kërkesës së saj për këtë shkak, me arsytimin se vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare dhe nuk mund t'i nënshtrohen gjykimit kushtetues, qëndrim ky i mbajtur dhe i elaboruar në mendimet paralele të vendimit nr. 18, datë 13.3.2024 të Gjykatës, si dhe në vendime të tjera të kësaj natyre në vijim.

B.1. Për cenimin e së drejtës së pronës

44. Sipas kërkujes, vendosja e sekuestros preventive mbi pasurinë objekt të kontratës së qirasë përbën kufizim të të drejtave të saj të ligjshme pasurore, gëzimi dhe posedimi, si rezultat i marrëdhënies kontraktore me shtetin, pasuri për të cilën është dhënë edhe leja e ndërtimit, kufizim që është shumë herë më i madh dhe thelbësor sesa arsyetohet në vendimet gjyqësore të kundërshtuara, të cilat kanë bllokuar të gjithë projektin investues, duke sjellë pasoja edhe në drejtim të interesit publik. Sipas saj, masa ka sjellë pasoja të mëdha financiare për kërkuesen, e cila jo vetëm që ka investuar vlera të konsiderueshme monetare, por është edhe e detyruar që t'u paguajë nënkontraktorëve penalitete për moszbatimin e kushteve të nënkontratave. Kërkuësja ka pretenduar se vendimet gjyqësore nuk kanë arsyetuar lidhur me proporcionalitetin e kufizimit të të drejtave pronësore, që i gëzon vetë shteti shqiptar si pronar i pasurisë objekt sekuestro, ashtu edhe të drejtave pasurore të kërkujes apo edhe të dëmeve që i janë shkaktuar dhe do t'i shkaktohen asaj dhe vetë shtetit nga mosrespektimi i kontratave (të koncesionit dhe qirasë) dhe i lejes së ndërtimit. Sipas kërkujes, nga vetë qëllimi i kontratës së qirasë dhe kushtet e saj është i qartë edhe elementi i interesit publik të investimeve të shoqërisë, jo vetëm për sa i përket infrastrukturës së bazës ndihmuese, por edhe në tërësi për investimin turistik, i cili do t'i kalojë shtetit në përfundim të afatit të kontratës së qirasë. Sipas saj, pretendimi i prokurorisë i pranuar nga gjykata për cenimin e sigurisë kombëtare nga delegimi i kompetencave të operacionalitetit të bazës nga KFD-ja te kërkuësja është një pretendim sa i pambështetur, aq sa edhe absurd, pasi nga faktet dhe rrethanat faktike, si dhe aktet provohet e kundërta, ndërkohë që interesi publik dhe siguria kombëtare janë duke u rrezikuar nga vendimet që kanë caktuar sekuestron preventive dhe nga situata faktike aktuale në pronën e sekuestruar.

45. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se mosrespektimi i dispozitave ligjore nga autoritet përgjegjëse gjatë veprimeve të tyre hedh dyshime të arsyeshme për konsumimin e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës" nga funksionarët publikë dhe vijimi i disponimit nga qiramarrësi/investitori, bazuar në kontratat e qirasë/koncesionit, e vendos pasurinë përballë rrezikut konkret të humbjes së plotë të funksionit themelor të saj. Sipas saj, sekuestroja preventive për pasurinë nr. 696 është vendosur pasi ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se kjo pasuri publike dhe aktet e nxjerra nga funksionarët publikë për disponimin e saj përbëjnë sende që lidhen me veprën penale dhe disponimi i lirë mbi pasurinë mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e veprës penale, duke vijuar me investime private për pronën publike, duke cenuar sigurinë kombëtare të një vendi, ruajtjen e gatishmërisë dhe operacionalitetit të njësisë ose reparteve të dislokuara në këto prona apo lehtësimin e kryerjes së veprave të tjera penale. Sipas këtij subjekti, ndërhyrja në të drejtën e pronës është bërë me ligj dhe i përgjigjet interesit publik, i cili është i prezumuar, pasi rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal në kuptim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike nga veprimtaria kriminale; ajo justifikon nevojën e ndërhyrjes, sepse synon të ndalojë rëndimin/zgjatjen e pasojave të veprës penale të dyshuar, si dhe të pengojë çdo lloj disponimi tjetër të mundshëm për pasurinë dhe aktet e tjera që lidhen me të, duke pasur synim final mbarëvajtjen e procedimit penal; masa është e përshtatshme pasi mbetet një mjet me natyrë të përkohshme, që balancon në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme qëllimin e procedimit penal me interesat e kërkujes dhe nuk është më e ashpër se sa objektivi që kërkohet të arrihet, pasi kufizimi i së drejtës së kërkujes për të gëzuar dhe poseduar pasurinë publike të marrë me qira vendoset përballë objektivit për parandalimin e kryerjes së mëtejshme të veprës penale; midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, ndaj kufizimi i së drejtës së kërkujes për të gëzuar dhe poseduar pasurinë publike të marrë me qira është në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar kufizimin.

46. Gjykata ka theksuar se e drejta e pronës e sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës përfshin tri garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: *garancia e parë* ka të bëjë

me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; *garancia e dytë* ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; *garancia e tretë* ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket ndërhyrjes që vendimi i sekuestrimit bën tek e drejta e pronës, Gjykata ka theksuar se: ai duhet të jetë i ligjshëm, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik; ndërhyrja duhet të vendosë një “ekuilibër të drejtë” midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe garancive për mbrojtjen e së drejtës së pronës; midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti. Ekziston një hapësirë e gjerë vlerësimi për autoritetet publike në lidhje me zgjedhjen e mjeteve dhe atë çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm. Ndërsa pranohet dyshimi i arsyeshëm në fillim të hetimeve penale si bazë për ndërhyrje në të drejtën e pronës, hetimet duhet të jenë të shpejta, në mënyrë që ndërhyrja të zgjasë për një kohë të kufizuar. Masat e përkohshme të vendosura në kuadër të procedurave gjyqësore, të cilat i paraprijnë një konfiskimi të mundshëm, mund të shkaktojnë dëmim të pronës, por në mënyrë që dëmi të jetë në përputhje me garancitë e lartpërmendura, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Gjykata, bazuar në natyrën e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesja dhe të të drejtave dhe interesave të saj që burojnë nga aktet dhe kontratat e lidhura mes saj dhe autoriteteve shtetërore, që kanë parashikuar të drejtën e saj për të investuar dhe zhvilluar një pasuri shtetërore, si dhe për ta gëzuar atë përgjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratave të lidhura në përfundim të procedurave ligjore (të koncesionit dhe marrjes me qira të pronës), vlerëson se ato përfshihen në fushën e veprimit të së drejtës së pronës, sipas nenit 41 të Kushtetutës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1, të KEDNJ-së. Thënë kjo, duke pasur parasysh përmbajtjen e këtyre dispozitave, ashtu edhe të nenit 17 të Kushtetutës që lejon kufizimin e të drejtave kushtetuese sipas kriterëve të përcaktuara prej tij, Gjykata do të ndalet në vijim në analizën nëse në rastin konkret ndërhyrja e bërë për shkak të caktimit të masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” ndaj pasurisë së paluajtshme të emërtuar “pasuria nr. 696” respekton kriteret e kufizimit. Në këtë analizë, Gjykata do t’i referohet edhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme, nëse ato, me vendimet për caktimin e masës së sekuestros, kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të qartë lidhjen e masës së sekuestros me objektivin, që është parandalimi i pasojave të mëtejshme të veprës penale dhe nëse ato kanë përcaktuar se cilin tagër të së drejtës së pronësisë do të prekin përtej disponimit të lirë të sendit, rreziku për ndodhinë e të cilit duket të jetë synimi kryesor dhe i shprehur i nenit 274 të KPP-së (*shih vendimin nr. 29, datë 16.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Sikurse ka pohuar në jurisprudencën e saj, për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, për sa kohë që në bazë të parimit të subsidiaritetit u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit, duke qenë kjo Gjykatë mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 19, datë 21.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Duke zbatuar standardet e mësipërme në rastin konkret në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimet gjyqësore të cilat kanë pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sekuestros preventive kanë vendosur një ndalim të përkohshëm në të drejtën e kërkueses për gëzimin e pronës me sipërfaqe 39446 m², që i përket pasurisë së paluajtshme nr. 696, pjesë e sipërfaqes së përgjithshme prej 265299.5 m², objekt i kontratës së qirasë së lidhur mes kërkueses dhe autoriteteve publike që kanë në administrim këto prona shtetërore, mbi bazë të së cilës kërkueses i është njohur e drejta ta zhvillojë për qëllime turizmi sipas lejes përkatëse të ndërtimit të dhënë nga KKT-ja. Kjo masë është vendosur në kuadër të procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme mbi bazën e kallëzimit të

shtetasit A.M. për veprime të paligjshme të kryera nga disa funksionarë publikë në procedurat e dhënies me qira të kësaj pasurie, të cilat ka dyshime se përbëjnë elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni i 248 KP-së. Baza ligjore për vendosjen e masës është neni 274 i KPP-së, sipas të cilit sekuestrimi urdhërohet kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Për rrjedhojë, rezulton se ndërhyrja është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik, të cilin Gjykata e ka konsideruar të prezumuar për sa kohë ka vlerësuar se rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarrëvajtjes së procedimit penal, në kuptimin e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike nga veprimtaria kriminale (*shih vendimin nr. 29, datë 16.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, në rastin konkret Gjykata vëren se marrja e sekuestros i përgjigjet interesit publik edhe në drejtim të mbrojtjes së sigurisë kombëtare të lidhur me gatishmërinë dhe operacionalitetin e FD-së, në kushtet kur prona në fjalë është pjesë e PVP-së së pronave të KFD-së.

49. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis sekuestros dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata merr në analizë, në linjë me praktikën e saj, disa elemente që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e pasojave që prodhon vendimi për vendosjen e masës së sekuestros, në kuptim të balancimit të të drejtave ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të individit, në këtë rast shoqëri tregtare. Për këtë qëllim ajo ndalet në vlerësimin e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sekuestros, duke mbajtur në konsideratë shpejtësinë e procedurave, pra që ndërhyrja në njërin prej tagrave të së drejtës së pronës (në rastin konkret gëzimi dhe disponimi i saj) të zgjasë për një kohë të kufizuar, si dhe dëmin që vjen nga cenimi, i cili nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme.

50. Lidhur me nevojën e ndërhyrjes, Gjykata ka theksuar se ajo analizon nëse masa e marrë është e aftë të realizojë pasojën që ajo synon, pra të sigurojë mbarrëvajtjen e procedimit penal në kuadër të të cilit është marrë (*shih vendimin nr. 29, datë 16.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me këtë aspekt të ndërhyrjes, Gjykata vëren se ndonëse kërkuesja nuk është pronare e pasurisë së paluajtshme objekt i sekuestros preventive, asaj i është njohur drejtpërdrejt nga autoritetet shtetërore e drejta për të investuar, gëzuar dhe disponuar mbi këtë pronë përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë, sipas termave dhe kushteve të kësaj kontrate dhe lejes përkatëse për zhvillimin e pronës që në thelb lidhet drejtpërdrejt me hetimet që po zhvillon prokuroria. Në këtë kuptim, sikurse ka prapësuar subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, për vendosjen e sekuestros, ekziston rreziku se disponimi i lirë për këtë pasuri mund të lehtësojë apo zgjasë pasojat e veprës penale në ngarkim të disa funksionarëve shtetërorë ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, ndaj masa parandalon rrezikun e tjetërsimit apo humbjes së pasurisë, dhe se kryerja e investimeve private mbi pronën publike në fushën e turizmit cenon sigurinë kombëtare, ruajtjen e gatishmërisë dhe operacionalitetit të FD-së. Lidhur me këtë, vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka konfirmuar qëndrimin e prokurorit me të njëjtin arsyetim në lidhje me rrezikun e disponimit të lirë të pasurisë (*shih faqen 14 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*), ndërkohë që gjykata e apelit ka vlerësuar, në kuptim të parashikimeve të nenit 274 të KPP-së, nëse pronat e përfshira në PVP mund të disponohen lirisht si pronat e tjera apo kanë status të veçantë, dhe se si përcaktohet operacionaliteti i pronave të përfshira në PVP, në kushtet kur shkaku i masës së sekuestros është rreziku i cenimit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të KFD-së dhe sigurisë kombëtare. Sipas asaj gjykate, pronat e përfshira në PVP nuk mund të jenë objekt material i kontratës së qirasë së pasurisë shtetërore, duke iu referuar ligjit nr. 64/2014 dhe vendimit të Gjykatës nr. 10, datë 26.2.2015, për kontrollin e këtij ligji, sipas të cilit PVP-ja është aspekt organizativ i drejtimit të F A-së me karakter strategjik, duke konsideruar se këto pasuri i shërbejnë sigurisë kombëtare të vendit, ruajtjes së gatishmërisë dhe operacionalitetit të njërive apo reparteve të dislokuara në to, ndaj çdo veprim për dhënien e tyre me qira duhet të paraprihet nga nxjerrja e tyre nga ky plan në përputhje me ligjin. Për rrjedhojë, ajo i ka gjetur të pabazuara shkaqet e ankimit që kanë të bëjnë me dhënien e

miratimit nga KFD-ja. Sipas GJKKO-së së Apelit, të vlerësuarit e strukturave të ndryshme, si KFD-ja, Shtabi i Përgjithshëm dhe MM-ja, duke e zbritur në nivel teknik diskutimin mbi mundësinë dhe detyrimin e ruajtjes së operacionalitetit nga pala investitore dhe qiramarrëse, nuk paraqesin vlerë juridike, pasi prona vijon të jetë në PVP, që ka një procedurë të posaçme të miratimit me ligjin nr. 64/2014. Në lidhje me kushtin tjetër të nenit 274, pika 1, të KPP-së, atë të rrezikut të vonesës, ajo gjykatë ka vlerësuar se shkaku që shërben për vendosjen e masës së sekuestros është mundësia që përdorimi apo aksesimi i pronës mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale, por nuk përjashtohet mundësia që të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, duke pasur parasysh se gjatë gjykimit prokuroria është shprehur se punimet për investim në fushën e turizmit dhe ndërtimi i portit turistik janë në ndërtim e sipër. Sipas asaj gjykate, masa parandaluese konsiderohet e përshtatshme në funksion të shmangies së mundësisë së rëndimit ose zgjatjes së pasojave të veprës penale dhe nuk përjashtohet as mundësia që lënia e aksesit në përdorim qiramarrëses (kërkueses) mbi pronën të lehtësojë edhe kryerjen e veprave të tjera penale, edhe për shkak të cilësisë së veçantë të saj, që i buron nga qenia në PVP, që përfaqëson aspekt organizativ të drejtimit të FA-së me karakter strategjik (*shih faqet 23, 25 - 29 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

51. Referuar vendimit të Kolegjit Penal, ka arsye të bazuara të mendohet se disponimi i lirë i pronës mund të ndikojë në shtimin e rrezikut mbi gatishmërinë dhe operacionalitetin e KFD-së, duke vënë në rrezik vazhdues interesat kombëtare e të sigurisë së Republikës së Shqipërisë, për sa kohë pala qiramarrëse/investitore ka akses në përdorimin e pronës në fjalë dhe se nga gjykatat e faktit është evidentuar ekzistenca e të dy kushteve të parashikuara nga neni 274, pika 1, i KPP-së, të nevojshme për vendosjen e masës së sigurimit me karakter pasuror, sekuestrimi i pasurive (*shih paragrafët 105 dhe 106 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

52. Sikurse rezulton nga vendimet gjyqësore janë evidentuar dhe analizuar dy elemente për të justifikuar vendosjen e masës së sekuestros preventive: i) fakti që prona është pjesë e PVP-së, ndaj nuk mund të jepet me qira si prona të tjera; ii) mundësia që përdorimi apo aksesimi i pronës mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale në ngarkim jo të kërkueses, por të disa funksionarëve shtetërorë ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Në rastin konkret, duke qenë se kjo është një pasuri publike dhe disponimi i lirë i pronës mund të ndikojë në shtimin e rrezikut mbi gatishmërinë dhe operacionalitetin e KFD-së, duke vënë në rrezik vazhdues interesat kombëtarë të sigurisë së Republikës së Shqipërisë, vendosja e masës së sekuestros preventive është e nevojshme, pasi është e aftë të pengojë cenimin e interesave kombëtarë të shtetit shqiptar deri në përfundimin e procesit penal në ngarkim të disa funksionarëve në kuadër të të cilit është marrë kjo masë.

53. Lidhur me përshtatshmërinë e masës, në vlerësimin e Gjykatës masa e sekuestros duhet të jetë e arsyeshme, duke balancuar qëllimin e procedimit penal me interesat e individit të përfshirë, në kuptimin që ajo nuk duhet të caktohet përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 29, datë 16.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, vëren se ato kanë arsyetuar në drejtim të këtij kriteri se arsyeshmëria e masës është e lidhur me paligjshmërinë e veprimeve të kryera nga disa funksionarë shtetërorë gjatë procedurës për dhënien me qira të pasurisë nr. 696, në përfundim të së cilës është lidhur dhe miratuar kontrata e qirasë mes kërkueses dhe MFE-së, veprime që janë konsideruar se përbëjnë elemente të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së, ashtu edhe se interesi publik i mbrojtjes kombëtare prevalon në këtë rast mbi interesat individuale. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kjo masë është e përshtatshme dhe jo përtej asaj që është e pashmangshme.

54. Lidhur me ashpërsinë e masës së sekuestros, Gjykata, duke e analizuar atë të lidhur me qëllimin e saj, që është parandalimi i pasojave të mëtejshme të veprës penale, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

55. Kështu, sipas njërit qëndrim u vlerësua se masa e sekuestros nuk tejkalon kriterin e ashpërsisë, duke mbajtur në konsideratë llojin e veprës penale dhe pasojat e saj në drejtim të interesit të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, e cila, siç ka theksuar edhe Gjykata e Lartë, ka epërsi ndaj interesave privatë të individëve, shoqërive tregtare, madje edhe atyre shtetërore. Në këtë pikë duhet evidentuar se objekti i procedimit penal lidhet me faktin e shpërdorimit të detyrës së funksionarëve të lartë shtetërorë për veprime që lidhen me administrimin e pronave të forcave ushtarake, që nuk përjashton mundësinë që pretendimi për pritshmëritë e kërkuësës të mos merret në mbrojtje nga parimi i sigurisë juridike. Për më tepër, kohëzgjatja prej rreth 1 viti e 9 muaj e sekuestros nuk është në atë shkallë që ta shndërrojë atë në një masë tepër të ashpër, duke ritheksuar se gjithsesi hetimet duhet të jenë të shpejta, në mënyrë që dëmi eventual i së drejtës së pronës së kërkuësës të jetë përtej asaj që është e pashmangshme. Nën dritën e këtyre argumenteve, konsiderohet se midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur duket se ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, prandaj kufizimi i së drejtës së kërkuësës është në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë².

56. Sipas qëndrimit tjetër, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kërkesë, duket se masa e sekuestros e tejkalon kriterin e ashpërsisë, pasi kërkuësës i është vendosur një barrë e tepruar, për sa kohë që veprimtaria e saj rezulton të jetë bazuar në procedura ligjore dhe akte nënligjore të miratuara nga autoritetet publike, çka ka bërë që për kërkuësen të lindin pritshmëri të ligjshme në drejtim të gëzimit të të drejtave dhe interesave që burojnë nga kjo marrëdhënie kontraktore dhe që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në fjalë. Në rastin konkret, kërkuësja ka hyrë në marrëdhënie me autoritet publike, bazuar në kompetencat dhe autoritetin e tyre, ndërkohë që nuk ka rezultuar që ajo të jetë vënë në dijeni apo të ketë pasur ndonjë informacion për mundësinë e prekjës së interesave shtetërorë apo për cenimin e sigurisë kombëtare. Gjykatat kanë vlerësuar vetëm faktin e përfshirjes së pasurisë nr. 696 në PVP, çka lidhet, sipas tyre, me operacionalitetin e bazës dhe sigurinë kombëtare dhe nuk kanë verifikuar situatën reale dhe faktike, nëse kanë ardhur pasoja në këtë drejtim, masën e tyre apo mundësinë e parikuperueshme të këtyre pasojave, as nëse pretendimet e kërkuësës për investimin e saj edhe në të mirë të interesit publik në këtë zonë janë të bazuara e gjejnë mbështetje te planet e investimit dhe aktet e lidhura me autoritetet shtetërore. Në këtë kuptim, pa vënë në dyshim rëndësinë e mbrojtjes së interesave shtetërorë, autoriteteve publike u lindte detyrimi për të realizuar një hetim të drejtë dhe të thelluar në mënyrë që të evitohet cenimi i të drejtave substanciale të personave të tretë në procesin penal (në rastin konkret kërkuësja), të cilët jo vetëm që nuk janë të përfshirë në veprimtari të paligjshme, por është provuar se kanë vepruar në *bona fide*. Për rrjedhojë, konsiderohet se masa e kundërshtuar është joproporcionale në drejtim të ashpërsisë së saj, ndaj kërkesa duhej pranuar³.

57. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkuësës konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

² Votuan për rrëzimin e kërkesës për këtë shkak gjyqtarët Holta Zaçaj, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji dhe Sandër Beci.

³ Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët Genti Ibrahimiri dhe Sonila Bejtja.

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 12.11.2024.

Shpallur, më 12.12.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 6 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket kërkuessës, shoqërisë “Marina Bay Saranda,” sh.p.k., me objekt: *“Shfuqizimi i vendimeve nr. 91, datë 24.2.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 9, datë 3.4.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2023-1001, datë 15.6.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtuesshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”*, ndaj mendimin për rrëzimin e kërkesës, duke mbajtur qëndrimin e pasqyruar në mendimin tim paralel në vendimin nr. 18, datë 13.3.2024 të Gjykatës, me kërkuessë shoqërinë “Kostur Kromi” sh.p.k., si dhe në vendimet e tjera të kësaj natyre, se vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare dhe nuk mund t’i nënshtrohen gjykimit kushtetues.

2. Në rastin konkret, fillimisht dua të theksoj se i qëndroj të njëjtit vlerësim që ka bërë Gjykata për përfshirjen në juridiksionin kushtetues në raste përjashtimore të vendimeve të ndërmjetme, nëse plotësohen njëherazi tri kushte: (i) kur shkëlja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimin nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Në lidhje me kriterin e tretë, sipas të cilit vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, vijoj të çmoj se ndonëse shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel duhet të jetë i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë.

4. Pavarësisht për sa më lart, një ndryshim i qasjes sime do të kishte qenë i justifikuar vetëm në kushtet e situatave të parashikuara në mendimin paralel, të dhënë në vendimin nr. 18, datë 13.3.2024 të Gjykatës, sipas të cilave: (1) pasojat e masës së sekuestros do të kishin qenë aq rënduese për një subjekt tregtar, sa që të kombinuara; (2) me tejzgjatjen e vazhdimësisë së masës do të sillnin si pasojë riskun e një falimentimi të mundshëm. Këto kushte do të analizohen në vijim nën dritën e rrethanave të rastit konkret, me qëllim që të evidentohet nëse mbetëm përsëri në qasjen time të shprehur në vendimin e sipërpërmendur.

5. Në këto kushte, duke analizuar rrethanat konkrete, në rastin në shqyrtim, konstatoj, se: (i) kohëzgjatja e vazhdimësisë së masës nuk është e tillë sa të kualifikohet si tejzgjatje e tepruar, sepse ajo shkon deri në 1 (një) vit e 9 (nëntë) muaj; (ii) kufijtë fizikë të pronës së prekur nga masa e sekuestros janë të tilla, që nuk e prekin të gjithë pronën në gjithë sipërfaqen e marrë për zhvillim, por prekin më pak se 15% të sipërfaqes së saj; (iii) leja e dhënë për ndërtimin/zhvillimin e pronës është miratuar dhe,

për rrjedhojë, kërkesja ka të drejtë të lejohet të operojë për fillimin ose vazhdimin e investimit të marrë përsipër në pjesën e pronës së paprekur nga masa e sekuestros. Për rrjedhojë, vlerësoj se kërkeses, nga njëra anë, nuk i është cenuar e drejta e saj për vazhdimin e marrëdhënies kontraktore që ajo ka me shtetin për zhvillimin e investimit për shkak të tejzgjatjes së masës së sekuestros ose kufizimit të pronës për zhvillim dhe, nga ana tjetër, nuk i janë shkaktuar pasoja financiare të tilla, që të rrezikojnë një gjendje paaftësie paguese ose falimentimi për kërkesen.

6. Për sa më lart, rasti konkret nuk vlerësohet prej meje si rast përjashtimor i tillë që të paraqesë kushte ose shkaqe të rëndësishme për ndryshimin e qasjes sime lidhur me standardin e pranuar prej meje, për sa i përket natyrës së vendimeve të caktimit të masës së sekuestros, si vendime që nuk mund të konsiderohen përfundimtare për gjykimin kushtetues.

Anëtare: Marjana Semini